

PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS, THIRRJA V

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, i ndryshuar, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall thirrjen e pestë të “Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”.

Informacionin rreth programit, profilet e kërkuara, numrin e praktikantëve dhe institucionet pjesëmarrëse mund t’i gjeni në linkun :

<http://praktika.arsimi.gov.al>

nga ku mund të kryeni edhe aplikimin online, pasi të klikoni në dritaren “Apliko”.

Aplikimi është i hapur për të rinjtë, që përmbushin këto kritere:

- ✓ Të jenë **21-26 vjeç**;
- ✓ Të kenë përfunduar **minimalisht** ciklin e parë të studimeve “**Bachelor**”;
- ✓ **Të mos kenë qenë pjesë** e programit gjatë **thirrjeve të mëparshme** .

Të rinjtë e interesuar duhet të aplikojnë vetëm në një institucion të caktuar, në të kundërt aplikimi i tyre nuk do të merret në konsideratë.

Dokumentet që duhet të ngarkojnë aplikantët janë :

- a- CV (jetëshkrim) e aplikantit;
- b- Letra e motivimit

Afati për aplikim është nga data 7 shkurt deri më datë 29 shkurt 2020.


Pas mbylljes së aplikimeve, institucionet përkatëse do të lajmërojnë nëpërmjet postës elektronike të përzgjedhurit për të filluar praktikën 3- mujore, nga data 9 mars – 9 qershor 2020.

Pjesëmarrësit do të përfshihen në një përvojë pune, në ndërveprim me profesionistët në administratën publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare, me qëllim përfitimin e njohurive praktike, pasurimin e jetëshkrimit të tyre, zgjerimin e rrjetit të kontakteve, pajisjen me të ashtuquajturat “aftësi të buta” si puna në grup, komunikimi i sigurtë, përshtatshmëria në ambjentin e punës, aftësia për të ndërmarrë iniciativa.

Periudha tre – mujore e praktikës do të njihet si përvojë pune nga Departamenti i Administratës Publike, ndërsa në përfundim të saj ofrohet punësim për mbi 200 më të mirët.

Programi Kombëtar
i Praktikave të Punës

[Kreu](#) [Rreth Programit](#) [Praktika e punës](#) [Institucionet](#) [Aplikimi](#) [Kontakt](#)



Zbulo veten tënde, bëhu pjesë e diçkaje më të madhe!

Jepi vetes mundësinë të përfitosh përvojë pune në Administratën Publike.

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Thirrja e pestë e programit është një mundësi e artë për të rinjtë nga **21 deri në 26 vjeç**, të cilët kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve "Bachelor" dhe nuk kanë qenë pjesë e programit gjatë thirrjeve të mëparshme.

Zbulo pozicionet

Apliko tani

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës

Thirrja e pestë e programit është një mundësi e artë për të rinjtë nga **21 deri në 26 vjeç** të cilët kanë përfunduar të paktën studimet e ciklit të parë bachelor.

Qëllimi i vërtetë është përvoja e punës

Zhvillimi i praktikës së punës është **pa pagesë** dhe qëllimi mbetet përfitimi i një **përvojë kualifikuese** për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive profesionale, akademike dhe personale.

Çfarë nevojitet për aplikimin tuaj?

Pasi të informoheni gjerësisht **rreth programit** dhe pas konsultimit të **profileve të kërkuara**, mund të vijoni me plotësimin e **formës së aplikimit**.

PROGRAMI NË SHIFRA

2500



Rreth Programit Kombëtar të Praktikave të Punës

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, shpall thirrjen e pestë për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera, Publike e Jopublike.

Zgjidh institucionin në qytetin ku ti jeton, dhe bëhu pjesë e Programit, për të fituar eksperiencën e dëshiruar të punës!



Shkurtimisht rreth Programit

Në këtë program ftohen të aplikojnë të rinj profesionistë nga mosha **21 deri 26 vjeç**, të cilët kanë përfunduar minimalisht ciklin e parë të studimeve 'Bachelor', dhe nuk kanë qenë pjesë e programit gjatë thirrjeve të mëparshme.

Kandidatët duhet të tregojnë interes për sektorin e përzgjedhur, si dhe të kenë aftësi shumë të mira analitike e komunikimi.

Zgjidh institucionin në qytetin ku ti jeton, dhe bëhu pjesë e Programit, për të fituar përvojën e dëshiruar të punës!

Kujdes: duhet të keni përfunduar minimalisht studimet e ciklit të parë 'Bachelor'!



Fazat e Programit

Faza e parë e këtij Programi, e njohur si 'periudha e praktikës' zgjat tre muaj, njihet si përvojë pune, gjatë rekrutimit në institucionet e administratës publike dhe është pa pagesë.

Faza e dytë ju ofron mundësinë për të fituar kontratën një - vjeçare të punës, bazuar në performancën individuale dhe kërkesat e vetë institucioneve.

Fituesit do të lajmërohen nëpërmjet adresës elektronike nga institucionet përkatëse

Emri

Mbiemri

Datëlindja

Adresa e banimit

Shteti ku jetoni

Adresa e-mail

Numër kontakti

Universiteti

Fakulteti

Dega

Lloji i diplomës

Nota mesatare